

PROJEKT-LIGJ
PËR LOBIMIN

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit 83, pika 1, e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon mënyrën dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, si dhe organizimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e tij, me qëllim sigurimin e transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim sigurimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes publike, nëpërmjet rregullimit të ushtrimit të veprimtarisë së lobimit pranë institucioneve publike të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për përfshirjen në veprimtari lobimi të:

- a) anëtarëve të Kuvendit, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ligjvënës;
- b) anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe funksionarëve politikë pranë tyre;
- c) nëpunësve të administratës publike që ushtrojnë funksione vendimmarrëse;
- ç) funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar në nivel vendor, si dhe punonjësve të njësive të vetëqeverisjes vendore që ushtrojnë funksione vendimmarrëse.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti kompetent” është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), i caktuar për të regjistruar, mbikëqyrur dhe kontrolluar ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, si dhe për të garantuar zbatimin e rregullave mbi transparencën dhe integritetin në proceset e lobimit.

2. **“Lobim”** nënkupton çdo veprimtari të ndërmarrë me qëllim ushtrimin e ndikimit në proceset e vendimmarrjes publike, legislative ose politikëbërëse, përmes çdo forme komunikimi apo takimeve formale ose joformale, me zyrtarë publikë, nga persona fizikë ose juridikë që përfaqësojnë interesa të caktuara.

3. **“Lobist”** nënkupton çdo person fizik të regjistruar si lobist, si dhe çdo person juridik që ushtron veprimtari lobimi përmes një lobisti të regjistruar, i cili, kundrejt shpërblimit ose në interes të drejtpërdrejtë, zhvillon veprimtari me qëllim ndikimin në hartimin, miratimin, ndryshimin ose zbatimin e legjislacionit, politikave publike ose vendimmarrjeve administrative, përmes komunikimit me zyrtarë publikë.

4. **“Përfitues i lobimit”** nënkupton çdo person fizik ose juridik privat, përfshirë organizatat jofitimprurëse, në emër të të cilit ose në interes të të cilit ushtrohet veprimtari lobimi nga një lobist i regjistruar.

5. **“Vendimmarrje publike”** nënkupton çdo proces ligjvënës, politikëbërës, rregullator ose administrativ, të ndërmarrë nga autoritetet publike në nivel qendror ose vendor, institucionet e pavarura dhe agjencitë autonome, që ka për qëllim miratimin, ndryshimin, zbatimin ose shfuqizimin e ligjeve, akteve nënligjore, politikave publike apo vendimeve që ndikojnë në interesin publik.

6. **“Zyrtari publik”** nënkupton çdo person që ushtron funksione publike dhe kompetenca vendimmarrëse në organet ligjvënëse, ekzekutive ose administrative, si dhe në shoqëri tregtare me kapital shtetëror, në nivel qendror ose vendor, përfshirë personat e zgjedhur, të emëruar dhe nëpunësit civilë.

Neni 5

Parime të përgjithshme

1. Veprimtaria e lobimit dhe marrëdhëniet ndërmjet lobistëve, përfituesve të tyre dhe zyrtarëve publikë udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:
 - a) **Parimi i ligjshmërisë**, sipas të cilit zyrtarët publikë ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
 - b) **Parimi i transparencës**, sipas të cilit veprimtaria e lobimit zhvillohet në mënyrë të deklaruar, të dokumentuar dhe të verifikueshme, me qëllim sigurimin e identifikimit dhe vlerësimit të ndikimit të interesave të lobistëve në procesin e vendimmarrjes publike.
 - c) **Parimi i llogaridhënies**, sipas të cilit zyrtarët publikë mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe vendimet e tyre dhe kanë detyrimin të deklarojnë dhe të raportojnë veprimtaritë e lobimit, në funksion të transparencës dhe kontrollit publik.
 - ç) **Parimi i integritetit**, sipas të cilit veprimtaria e lobimit zhvillohet në përputhje me ligjin, standardet e etikës profesionale dhe interesin e përgjithshëm, duke shmangur çdo formë ndikimi të paligjshëm ose korrupsioni.

- d) **Parimi i paanshmërisë**, sipas të cilit zyrtarët publikë që kanë kontakte me lobistë ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke ruajtur neutralitetin institucional dhe etik, si dhe duke vepruar në përputhje me interesin e përgjithshëm dhe jo në favor të interesave të veçanta.
- dh) **Parimi i pavarësisë**, sipas të cilit zyrtarët publikë ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i jashtëm, duke garantuar që vendimmarrja publike të bazohet në ligjshmëri, objektivitet dhe për interes publik.
- e) **Parimi i barazisë**, sipas të cilit të gjitha palët e interesuara gëzojnë trajtim dhe mundësi të barabarta për të ushtruar veprimtari lobuese dhe për të paraqitur interesat e tyre pranë institucioneve publike, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.
- f) **Parimi i mbrojtjes së interesit publik**, sipas të cilit veprimtaria e lobimit dhe ushtrimi i funksioneve nga zyrtarët publikë zhvillohen në mënyrë që të garantohet se vendimmarrja publike nuk cenon interesin publik, integritetin e institucioneve dhe besimin e qytetarëve në proceset demokratike.

KREU II

KUSHTET PËR USHTRIMIN E LOBIMIT DHE KRITERET NDALUESE

Neni 6

Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit

Veprimtaria e lobimit ushtrohet nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 7

Kriteret detyruese për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së lobimit

1. Çdo person fizik ose juridik, që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, ndalohet të ushtrojë veprimtari lobimi për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky ndalim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së lobimit zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese ndaj tij.

2. Çdo person fizik ose juridik ndalohet të ushtrojë veprimtari lobimi kur ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh.

3. Nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi personi juridik që:

- a) është në proces falimentimi ose likuidimi;
- b) ka asete të administruara nga gjykata ose nga administrator falimentimi;
- c) ka pezulluar veprimtarinë tregtare;
- ç) ka lidhur marrëveshje me kreditorët për shlyerje të borxheve, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi çdo person fizik ose juridik që:

- a) ka ushtruar veprimtari lobimi përpara regjistrimit në Regjistrin e Lobimit;
- b) nuk ka përmbushur detyrimet për raportim dhe deklarim sipas nenit 25 të këtij ligji, me krijimin e Regjistrit të Lobimit.

Neni 8

Veprimtari që nuk konsiderohen lobim

Nuk konsiderohen veprimtari lobimi, në kuptim të këtij ligji:

- a) Ushtrimi i lirive dhe të drejtave themelore demokratike nga individët, përfshirë të drejtën për informim, paraqitjen e kërkesave, peticioneve ose qëndrimeve publike, për sa kohë që këto veprimtari nuk zhvillohen përmes marrëdhënieve të strukturuar të lobimit.
- b) Pjesëmarrja e hapur dhe transparente në proceset e konsultimit publik, dëgjesat publike apo takimet e organizuara nga institucionet shtetërore, kur nuk ekziston kontratë apo pagesë për lobim.
- c) Aktivitetet edukative, kërkimore, akademike ose analitike të zhvilluara në mënyrë të pavarur dhe për qëllime informuese, që nuk synojnë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje përmes marrëdhënieve të strukturuar të lobimit.
- ç) Komunikimi ndërmjet institucioneve publike, organeve të administratës publike ose përfaqësuesve të tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ligjore.
- d) Komunikimet ose veprimtaritë e kryera nga partitë politike gjatë ushtrimit të funksioneve dhe të drejtave të tyre të përcaktuara me ligj.
- dh) Publikimet, shkrimet ose opinionet e botuara në media, si dhe shprehjet publike në rrjete sociale ose në aktivitete publike, për sa kohë që nuk zhvillohen në kuadër të marrëdhënieve të strukturuar të lobimit.

- e) Veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të procedurave administrative apo gjyqësore, përfshirë përfaqësimin ligjor ose procedural të palëve.
- ë) Deklaratat dhe qëndrimet publike të organizatave jo-fitimprurëse për çështje që lidhen drejtpërdrejtë me misionin e tyre statutor dhe janë pjesë e fushës së tyre të veprimtarisë dhe ekspertizës, për sa kohë këto nuk financohen ose nuk kryen me qëllim të posacëm lobimi për llogari të një pale të tretë.

KREU III

REGJISTRIMI DHE HEQJA NGA REGJISTRI I LOBIMIT

Neni 9

Regjistri i Lobimit

1. Regjistri i Lobimit mbahet dhe administrohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoritet kompetent për monitorimin e veprimtarisë së lobimit, dhe përbën një bazë të dhënash elektronike publike, e aksesueshme nga çdo person, në përputhje me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Të dhënat në Regjistrin e Lobimit përditësohen në mënyrë periodike dhe jo më vonë se tre (3) ditë nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Struktura, përmbajtja, mënyra e administrimit, si dhe procedurat për përditësimin dhe publikimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe ushtron këto funksione:
 - a) administron dhe publikon në kohë reale të dhënat në Regjistrin e Lobimit;
 - b) shqyrton dhe vendos mbi aplikimet për regjistrim të lobistëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj;
 - c) mbikëqyr zbatimin e detyrimeve ligjore nga lobistët, përfituesit e lobimit dhe zyrtarët publikë;
 - ç) verifikon saktësinë e të dhënave dhe raporteve të dorëzuara, përmes kontrolleve dhe hetimeve administrative;
 - d) zbaton masat administrative dhe ndëshkimet e parashikuara në këtë ligj;
 - dh) harton dhe miraton Kodin e Sjelljes për Lobistët dhe monitoron zbatimin e tij;
 - e) zhvillon dhe koordinon aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere për lobistët, zyrtarët publikë dhe publikun e gjerë, me qëllim rritjen e njohurive mbi rregullat e lobimit, detyrimet ligjore dhe masat për parandalimin e ndikimeve të papërshtatshme.

2. Autoritetet publike dhe institucionet e përfshira në procese vendimmarrëse janë të detyruara të bashkëpunojnë me KDIMDP për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, si dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e punonjësve të tyre në këto veprimtari.
3. Format, temat dhe periudhat e zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere përcaktohen me urdhër të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke garantuar zhvillimin e tyre jo më pak se një herë në vit.
4. KDIMDP përgatit dhe paraqet çdo vit në Kuvend një raport vjetor mbi veprimtarinë e tij, gjendjen e lobimit në vend dhe rekomandimet për përmirësim.

Neni 11

Përmbajtja e Regjistrit të Lobimit

1. Regjistri i Lobimit mbahet dhe administrohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe përmban të dhëna mbi personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari lobimi, përfituesit e lobimit dhe raportimet për kontaktet lobuese, në përputhje me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Regjistri publikisht përmban këto të dhëna:
 - a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e personit fizik që ushton veprimtari lobimi, ose emrin, selinë dhe numrin unik të identifikimit (NUIS) të personit juridik;
 - b) përfaqësuesin ligjor dhe, në rastet e personit juridik, personat e punësuar si lobistë;
 - c) fushën dhe temat e lobimit;
 - ç) përfituesin ose subjektin në emër të të cilit zhvillohet veprimtaria e lobimit;
 - d) institucionet publike ose kategoritë e zyrtarëve publikë me të cilët janë zhvilluar kontakte lobuese;
 - dh) datën e regjistrimit, statusin aktual në regjistër (aktiv, fshirë) dhe afatin e vlefshmërisë së regjistrimit;
 - e) raportimet e zyrtarëve publikë për kontaktet e zhvilluara me lobistët;
 - ë) vendimet e KDIMDP për regjistrimin, refuzimin, pezullimin ose fshirjen nga Regjistri i Lobimit.
3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale administron, por nuk publikon, të dhënat e mëposhtme:
 - a) numrin personal të identifikimit (NID) të personave fizikë;
 - b) kopjet e kontratave të lobimit, duke përfshirë periudhën dhe shpërblimin;
 - c) deklaratat periodike mbi buxhetin dhe shumat e shpenzuara për lobim;

- ç) çdo dokument që përmban të dhëna konfidenciale ose të mbrojtura sipas ligjit.
4. Të dhënat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni mund të përdoren nga KDIMDP vetëm për qëllime verifikimi, kontrolli, raportimi statistikor ose bashkëpunimi institucional, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretet tregtare.
 5. Në rast se ndodhin ndryshime në të dhënat e regjistruara, lobisti ka detyrimin të njoftojë KDIMDP dhe të dorëzojë dokumentacionin përkatës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ndryshimit. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përditëson dhe publikon të dhënat përkatëse brenda 3 (tre) ditëve pune nga depozitimi i dokumentacionit.

Neni 12

Kërkesa për regjistrim

1. Çdo person fizik ose juridik që kërkon të ushtrojë veprimtari lobimi paraqet kërkesë për regjistrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në formë elektronike ose me shkrim.
2. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kopje të dokumentit të identifikimit të kërkuarit;
 - b) dokumentacion provues që vërteton mungesën e ndalimeve të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji;
 - c) përshkrimin e fushës dhe temave në të cilat do të ushtrohet veprimtaria e lobimi.
3. Në rastin e personit juridik, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, kërkesa shoqërohet edhe me:
 - a) ekstraktin aktual të regjistrimit të personit juridik;
 - b) aktin e themelimit dhe statutin;
 - c) të dhënat identifikuese të përfaqësuesit ligjor dhe kopjen e kontratës së punës për lobistin e punësuar;
 - ç) dokumentacioni provues për mungesën e ndalimeve ligjore për personin juridik dhe përfaqësuesin e tij ligjor.
4. KDIMDP shqyrton kërkesën për regjistrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes dhe, nëse është e nevojshme, kërkon plotësimin e dokumentacionit brenda një afati shtesë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Afati i shqyrtimit pezullohet deri në dorëzimin e dokumenteve të kërkuara.
5. Pas shqyrtimit, KDIMDP merr vendim për:
 - a) regjistrimin e kërkuarit në Regjistrin e Lobimit, ose
 - b) refuzimin e kërkesës kur konstatohet mospërmbushje e kushteve ligjore.
6. Vendimi për regjistrim i komunikohet kërkuarit dhe publikohet në faqen zyrtare të KDIMDP. Vendimi për refuzim i komunikohet vetëm kërkuarit, duke përfshirë arsyetimin përkatës.

7. Formati dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrim, si dhe mënyra e paraqitjes dhe shqyrtimit të saj, përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 13

Refuzimi i regjistrimit

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale refuzon kërkesën për regjistrim në Regjistrin e Lobimit në rastet kur:
 - a) konstatohet ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve ndaluese të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji;
 - b) kërkuuesi ka paraqitur të dhëna ose dokumente të pavërteta ose të pasakta;
 - c) për kërkuuesin nuk ka përfunduar afati i ndalimit për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligji.
2. Vendimi për refuzim duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i komunikohet kërkuarit brenda afatit të parashikuar në nenin 12 të këtij ligji.
3. Kundër vendimit të refuzimit të regjistrimit, kërkuuesi ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë KDIMDP.

Neni 14

Heqja nga regjistri

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos heqjen nga regjistri për lobimin, në këto raste:
 - a) Me kërkesë të lobistit;
 - b) Kur ka vdekur personi fizik ose kur ka humbur zotësinë juridike për të vepruar;
 - c) Kur personi juridik ka mbaruar ose ka nisur procedurat e falimentimit;
 - ç) moskorrigjimi i të dhënave të pasakta pas kalimit të afatit të parashikuar në neni 27;
 - d) Kur lobisti ndodhet në një nga rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 7, të ligjit;
 - dh) Kur zbulohen të dhëna se lobisti ka ushtruar aktivitet lobimi pa qenë me parë i regjistruar.
2. Vendimi për heqjen nga regjistri është i arsyetuar dhe i komunikohet menjëherë lobistit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të KDIMDP brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi.
3. Subjekti ndaj të cilit është marrë vendimi për heqjen nga regjistri nuk mund të paraqesë kërkesë të re për regjistrim për një periudhë jo më pak se tre (3) vjet nga data e marrjes së vendimit.
4. Kundër vendimit për heqjen nga regjistri, lobisti ka të drejtë të paraqesë ankim pranë KDIMDP brenda 30 ditëve nga njoftimi.

KREU IV
KRYERJA E VEPRIMTARISË SË LOBIT, TË DREJTAT DHE DETYRIMET
E LOBISTËVE

Neni 15

Kontrata për lobim

1. Lobisti nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi pa lidhur më parë një kontratë me shkrim me përfituesin e lobimit, përveç rasteve kur lobimi kryhet për interesa të drejtpërdrejta të tij. Kontrata dorëzohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e lidhjes dhe regjistrohet në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me parashikimet e nenit 11 të këtij ligji.
2. Kontrata për lobim përmban, paktën:
 - a) të dhënat identifikuese të palëve kontraktuese;
 - b) objektin e lobimit, përfshirë përshkrimin e çështjes, fushën dhe qëllimin;
 - c) afatin dhe mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të lobimit;
 - ç) shumën e shpërblimit dhe mënyrën e pagesës, si dhe çdo kontribut tjetër financiar ose në natyrë;
 - d) deklaratën e lobistit ose të përfaqësuesit të personit juridik mbi mungesën e konfliktit të interesit.dh) identitetin e çdo subjekti të tretë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të lobimit.
4. Kur njëra palë është person juridik, kontrata duhet të përmbajë edhe emrin dhe mbiemrin e lobistit që do të ushtrojë veprimtarinë e lobimit.
5. Kontrata e lobimit nuk mund të parashikojë shpërblime të kushtëzuara nga rezultati i lobimit (*success fees*).
6. Çdo ndryshim i kontratës së lobimit duhet të dorëzohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditëve dhe të përditësohet në Regjistrin e Lobimit brenda 3 (tre) ditëve nga depozitimi.
7. Kopjet e kontratave të lobimit, përfshirë shpërblimin dhe periudhën e saj, administrohen nga KDIMDP, në përputhje me nenin 11 pika 3 të këtij ligji. Nga kontratat mund të publikohen vetëm të dhëna bazë, si: palët kontraktuese, fushat e lobimit dhe afati i vlefshmërisë së kontratës.

Neni 16

Informacionit mbi përfituesin e lobimit

1. Lobisti që ushtron veprimtari lobimi është i detyruar të paraqesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës së lobimit, informacion mbi:
 - a) të dhënat identifikuese të përfituesit të lobistit;
 - b) burimet financiare të planifikuara për veprimtarinë e lobimit;
 - c) deklaratë mbi mungesën e konfliktit të interesit;
 - ç) vetë-deklarimine përfituesit se nuk është i dënuar për vepra penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji.
2. Çdo ndryshim në kontratë ose në objektin e lobimit duhet të njoftohet tek KDIMDP dhe pasqyrohet në Regjistrin e Lobimit brenda 30 ditëve nga ndryshimi.
3. KDIMDP administron informacionin mbi përfituesin e lobimit në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, duke publikuar vetëm të dhëna bazë për qëllime transparence, pa ekspozuar të dhëna konfidenciale, financiare ose personale të mbrojtura me ligj..

Neni 17

Detyrimi për bashkëpunim dhe përgjegjësia e përfituesit të lobimit

1. Përfituesi i lobimit është i detyruar ti sigurojë lobistit dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për përmbushjen e kontratës së lobimit, si dhe të bashkëpunojë me KDIMDP për qëllime verifikimi dhe kontrolli.
2. Përfituesi i lobimit mban përgjegjësi të përbashkët me lobistin për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të dorëzuara pranë KDIMDP.
3. Në rast të paraqitjes së të dhënave të pasakta ose të pavërteta, përfituesi i lobimit i nënshtrohet masave administrative dhe sanksionave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 18

Mbledhja dhe përdorimi i informacionit

1. Lobisti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me kontratën e lobimit dhe me parimet e transparencës, integritetit dhe mbrojtjes së interesit publik.
2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, lobisti është i detyruar të mbledhë, përdorë dhe raportojë vetëm të dhëna dhe informacione të sakta dhe të verifikueshme, të cilat ia paraqet përfituesit të lobimit dhe KDIMDP, sipas kërkesës.

3. Mbledhja e informacionit kryhet vetëm nga burime të hapura, të ligjshme dhe të disponueshme publikisht, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e sekretit tregtar.
4. Lobisti nuk duhet të nxisë persona të tjerë për t'i dhënë informacione të përfituara në mënyrë të kundërligjshme dhe nuk mund të përdorë informacione të tilla në ushtrimin e veprimtarisë së tij.
5. Lobisti mban përgjegjësi administrative dhe civile për pasaktësinë ose përdorimin e qëllimshëm të informacionit të pavërtetë në procesin e lobimit.

Neni 19

Të drejtat e lobistëve

1. Çdo lobist ka të drejtën të ushtrojë veprimtarinë e lobimit në përputhje me këtë ligj dhe të përfitojë mbrojtje ligjore gjatë ushtrimit të saj.
2. Lobisti ka të drejtën:
 - a) të kërkojë qasje të barabartë dhe transparente në takime me institucione publike, sipas rregullave të këtij ligji;
 - b) të informohet mbi proceset ligjvënëse dhe vendimmarrëse në institucionet publike, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit;
 - c) të marrë pjesë në konsultime publike dhe dëgjesa publike, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - ç) të paraqesë ankesë ose të kërkojë rishikim në rast se i mohohet e drejta për ushtrimin e ligjshëm të veprimtarisë së lobimit;
 - d) të kërkojë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale udhëzime dhe sqarime mbi zbatimin e këtij ligji dhe të Kodit të Sjelljes për Lobistët.

Neni 20

Detyrimet e lobistëve

Lobisti është i detyruar:

- a) të deklarojë qëllimin e lobimit dhe subjektin për llogari të të cilit vepron në çdo kontakt me zyrtarët publikë;
- b) të mos përdorë forma ndikimi të paligjshme ose korruptive, përfshirë dhurata, favore, premtime apo shpërblime të ndaluara;
- c) të respektojë Kodin e Sjelljes për Lobistët, rregullat e etikës profesionale dhe transparencës në komunikimin me institucionet publike;
- ç) të dorëzojë raportet periodike sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj;
- d) të ruajë dhe të mbajë dokumentacionin për aktivitetet e lobimit për një periudhë jo më pak se pesë (5) vjet dhe ta vërë në dispozicion të KDIMDP kur kërkohet;
- dh) të bashkëpunojë me KDIMDP gjatë procedurave të verifikimit ose hetimit administrativ;
- e) të mos përdorë dhe të mos shpërndajë informacione të përfituara në mënyrë të paligjshme, si dhe të respektojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin tregtar dhe sekretin shtetëror.

Neni 21

Deklarimi i burimeve financiare dhe shpenzimeve për lobim

1. Lobisti ka detyrimin të paraqesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale një deklaratë periodike, çdo gjashtë (6) muaj, mbi burimet financiare dhe shumat e shpenzuara për veprimtarinë e lobimit gjatë periudhës përkatëse.
2. Deklarata përmban të dhëna mbi:
 - a) burimet financiare të planifikuara për lobim;
 - b) vlerën totale të shpenzimeve të realizuara për lobim gjatë periudhës së deklaruar;
 - c) natyrën dhe qëllimin e veprimtarive të lobimit të kryera;
 - ç) institucionet publike apo zyrtarët me të cilët janë zhvilluar kontakte lobuese;
 - d) format dhe datat e kontakteve me zyrtarët publik;
 - dh) burimin e fondeve të përdorura për lobim dhe çdo mbështetje financiare nga palë të treta.
3. Deklarata dorëzohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe publikohet në Regjistrin e Lobimit në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, duke respektuar parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
4. Nëse gjatë periudhës së raportimit nuk është zhvilluar asnjë aktivitet lobimi, lobisti është i detyruar të paraqesë një deklaratë, ku deklaron këtë fakt.
5. Mosparaqitja e deklaratës brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i periudhës raportuese përbën kundërvajtje administrative..
6. Forma, përmbajtja dhe mënyra e dorëzimit të deklaratës përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU V

NDALIMET DHE KONFLIKTI I INTERESIT GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË LOBIMIT

Neni 22

Ndalimi i lobimit për ish-zyrtarët publikë

1. Ish-anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët e Kuvendit, drejtuesit e institucioneve të pavarura, sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e përgjithshëm të agjencive rregullatore dhe çdo funksionar publik që ka ushtruar funksione vendimmarrëse, nuk mund të ushtrojnë veprimtari lobimi për një periudhë dy vjeçare pas përfundimit të mandatit ose detyrës.
2. Gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 1, ish-zyrtari publik ndalohet të kryejë lobim:

- a) pranë institucionit ku ka ushtruar detyrën;
 - b) për çështje mbi të cilat ka pasur kompetencë vendimmarrëse ose përgjegjësi të drejtpërdrejtë;
 - c) për llogari të një subjekti me të cilin ka pasur marrëdhënie kontraktuale, mbikëqyrëse ose kontrolluese gjatë ushtrimit të funksionit.
3. Ish-zyrtari publik nuk mund të shfrytëzojë informacione jo publike ose konfidenciale, të përfituara gjatë ushtrimit të detyrës, për qëllime lobimi apo përfitimi personal.
 4. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbikëqyr dhe publikon një listë të përditësuar të ish-zyrtarëve që përfshihen në këtë dispozitë dhe monitoron zbatimin e periudhës së ndalimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Neni 23

Ndalimi i përfaqësimit të interesave të huaja

1. Lobistët nuk mund të përfaqësojnë interesa të shteteve të huaja dhe institucioneve publike të tyre, kur këto përfaqësime:
 - a) bien ndesh me interesin publik dhe parimet e rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë;
 - b) cenojnë sigurinë kombëtare, politikën e jashtme ose marrëdhëniet ndërkombëtare të vendit;
 - c) synojnë të ushtrojnë ndikim në kundërshtim me ligjet për financimin e partive politike dhe zgjedhjeve.
2. Çdo kontratë lobimi me subjekte të huaja duhet të deklarohet në regjistër dhe i nënshtrohet një shqyrtimi të posaçëm nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Rregullat për shqyrtimin e posaçëm do të miratohen me udhëzim të nxjerrë nga KDIMDP.

Neni 24

Parandalimi i konfliktit të interesit në veprimtarinë e lobimit

1. Lobisti nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi në çështje ku ai vetë, anëtarët e familjes së tij ose subjektet me të cilat ka lidhje ekonomike, profesionale apo kontraktuale kanë interes të drejtpërdrejtë.
2. Lobisti ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit kur:
 - a) përfaqëson ose angazhohet për dy ose më shumë përfitues lobimi që kanë interesa të kundërta në të njëjtën çështje;
3. Lobisti ka detyrimin të deklarojë paraprakisht çdo rrethanë që mund të përbëjë konflikt interesi.

4. Shkelja e këtij neni sjell heqjen e përkohshme nga regjistri dhe përbën kundravajtje administrative.

KREU VI MBIKËQYRJA DHE SANKSIONET

Neni 25

Veprimtaria kontrolluese e autoritetit përgjegjës për lobimin

1. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe përputhshmërinë e veprimtarive të lobimit me të dhënat e regjistruara.
2. Për këtë qëllim, KDIMDP ka të drejtë:
 - a) të kërkojë informacion nga lobistët dhe përfituesit e lobimit;
 - b) të verifikojë dokumentet dhe raportet e dorëzuara;
 - c) të kërkojë sqarime nga zyrtarët publikë për kontaktet e zhvilluara me lobistë.
3. Kur konstaton shkelje, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr masa administrative sipas këtij ligji.
4. KDIMDP raporton një herë në vit mbi rezultatet e mbikëqyrjes dhe masat e marra, duke e bërë publik raportin në faqen e tij zyrtare.

Neni 26

Verifikimi i të dhënave në Regjistrin e Lobistëve

1. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale verifikon saktësinë e të dhënave të regjistruara dhe përditësimin e tyre, sipas procedurave të përcaktuara me akt nënligjor.
2. Në rast konstatimi të pasaktësive ose mospërputhjeve, autoriteti përgjegjës për lobimin njofton menjëherë lobistin, i cili është i detyruar të marrë masat e nevojshme për korrigjimin e të dhënave brenda një afati prej 30 ditësh.
3. Moskorrektimi i të dhënave brenda afatit të përcaktuar sjell heqjen e subjektit nga Regjistri i Lobistëve.
4. Procedurat dhe afatet për kryerjen e verifikimeve sipas këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 27

Transparenca, kontrolli dhe administrimi i raporteve për aktivitetet e lobimit

1. Çdo zyrtar publik që zhvillon kontakt me një lobist është i detyruar të raportojë këtë kontakt pranë autoritetit përgjegjës për lobimin, brenda 15 ditëve nga data e kontaktit.

2. Raporti përmban të dhëna të përgjithshme mbi:
 - a) identitetin e lobistit;
 - b) datën dhe mënyrën e kontaktit;
 - c) temën e diskutuar.
3. Autoriteti përgjegjës për lobimin për zbatimin e këtij ligji shqyrton raportet e dorëzuara nga zyrtarët publikë, në lidhje me kontaktet e realizuara gjatë veprimtarisë të lobimit.
4. Autoriteti përgjegjës për lobimin verifikon përputhshmërinë e raportimeve me dispozitat e këtij ligji, përfshirë rregullat mbi transparencën, konfliktin e interesit dhe ndalimin e lobimit të paligjshëm dhe mund të kryejë verifikime të pavarura mbi saktësinë e tyre.
5. Raportet regjistrohen në Regjistrin e Lobimit dhe publikohen online, përveç rasteve kur përmbajnë informacion që përbën sekret shtetëror. Në çdo rast, të dhënat personale publikohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, plotësisht ose të anonimizuara.
6. Mosdeklarimi ose raportimi i pasaktë i kontakteve lobuese përbën kundravajtje administrative dhe sanksionohet sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 28

Sanksionet administrative

Shkelja e dispozitave të këtij ligji ndëshkohet me masa administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe natyrën e shkeljes, si më poshtë:

- a) ushtrimi i veprimtarisë së lobimit në kushtet e mosregjistrimit, dënohet me gjobë në masën **500.000** lekë dhe shoqërohet me ndalimin për regjistrimin si lobist deri në 3 vite.
- b) mosdeklarimi i të dhënave të sakta dënohet gjobë nga **300.000** deri në **500.000** lekë;
- c) moskorrigjimi i të dhënave të pasakta dënohet gjobë nga **100.000** deri në **300.000** lekë;
- ç) mosraportimi i kontakteve lobuese nga zyrtarët publikë dënohet gjobë nga **300.000** deri në **500.000** lekë.
- d) raportimi i pasaktë i kontakteve lobuese nga zyrtarët publikë dënohet gjobë nga **100.000** deri në **200.000** lekë.
- dh) mosparaqitja e deklaratës mbi shumat e shpenzuara për lobim brenda 30 ditëve përbën kundërvajtje administrative, dënohet gjobë nga **100.000** deri në **300.000** lekë.
- e) mosrespektimi i Kodit të Sjelljes dënohet me gjobë nga **50.000** deri në **200.000** lekë.

Neni 29

Ankimimi

1. Vendimet e KDIMDP mund të ankimohen pranë në gjykatë, në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative.

Neni 30

Detyrimi i autoriteteve publike për zbatimin e ligjit

1. Autoritetet publike qendrore dhe vendore bashkëpunojnë me Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij ligji, duke i vënë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumentet përkatëse.
2. Refuzimi për të bashkëpunuar ose mosdhënia e informacionit përbën shkelje administrative dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Aktet nënligjore

1. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratojnë aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji. Aktet nënligjore rregullojnë, ndër të tjera:
 - a) procedurat për regjistrimin dhe mbajtjen e Regjistrit të Lobistëve;
 - b) formatet e raportimit dhe mënyrën e publikimit të të dhënave;
 - c) rregullat e etikës dhe Kodin e Sjelljes në veprimtarinë e lobimit.
2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ndërmerr të gjitha masat administrative, teknike dhe organizative për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datë_____